

PUBLIKON

Rrjeti për zhvillim rural i
Republikës së Maqedonisë
www.ruralnet.mk
email: info@ruralnet.mk

"Kosta Veselinov" 3a
1000 Skopje
R. e Maqedonisë
T: +389 (2) 3075 506
F: +389 (2) 3075 503



**Në këtë
numër:**



**1. STACION
METEOROLOGJIK
PËR ADAPTIM
MË TË MIRË
NDAJ KUSHTEVE
KLIMATIKE NË
BUJQËSI**



**2. PROJEKT PËR
EFIKASITET
ENERGJETIK NË
KOMUNËN E VINICËS**



**3. SHËNOHET DITA E
NDËRKOMBËTARE TË
GRUAS RURALE**



**4. U SHËNUA DITA
NDËRKOMBËTARE
E PERSONAVE ME
INVALIDITET, 3
DHJETORI**



**5. FESTIVALI "CERGE
BALLKANIKE"**



**6. PARLAMENTI RURAL
SUEDEZ**



**7. KONFERENCA
KOMBËTARE ÇEKE
"HAPËSIRA RURALE
2012"**



STACION METEOROLOGJIK PËR ADAPTIM MË TË MIRË NDAJ KUSHTEVE KLIMATIKE NË BUJQËSI

Rrjeti për Zhvillim Rural i RM-së dhe grupi investues M6 firmosën Memorandum për Bashkëpunim për të vendosur një stacion meteorologjik në vendin "Lepovo", rrethinën e Netoginës, që është në pronësi të M6. Me këtë marrëveshje M6 i mundëson projektit të USAID-it për adaptimin e bujqësisë ndaj kushteve klimatike që falas të përdor hapësirën në vinarinë. Nga ana tjetër, M6 do të ketë qasje në informatat e fituara nga stacioni meteorologjik dhe do të mund të përdor për nevoja të veta dhe të shkëmbje me prodhuesit e bashkësisë lokale për të përmirësuar cilësinë e produkteve të tyre.

„Shkëmbimi i informatave me vreshtarët në rajon do të ndihmojë

që të përforcohen kapacitetet e sektorit të verës dhe shpresojmë që me këtë do të nxitet edhe bashkëpunimi i tyre i mëtutjeshëm”, tha Robert Vurc, Drejtori i Misionit të USAID-it në Maqedoni. “Me rëndësi është të theksohet se informatat për kushtet e motit që i grumbullojmë do të ndihmojnë fermerët gjatë marrjes së vendimeve dhe përmirësimit të punës së tyre. Kjo do të përmirësojë shkathtësinë e tyre të adaptohen ndaj ndryshimeve klimatike dhe në atë mënyrë do të ruajnë ose përmirësojnë punën dhe të ardhurat e tyre.”

„Ndryshimet klimatike me shpejtësi të madhe i ndryshojnë kushtet në bujqësi dhe me atë edhe fushat tjera lidhur ngushtë me këtë lëmi

dhe prandaj jemi shumë të lumtur që do të përfshihemi në këtë projekt. Me atë neve e plotësojmë funksionin tonë shoqëror dhe përgjegjës që e kemi vendosur për të ndihmuar sektorin dhe përballimin më të suksesshëm me sfidat që i imponojnë ndryshimet klimatike në Maqedoni, pasojat e të cilës vetëm më i ndjeshmë”, deklaroi Svetozar Janevski gjatë firmosjes së Memorandumit, duke theksuar që me këtë hapet dera për një bashkëpunim më të thellë me projektin që e zbaton Rrjeti për Zhvillim Rural në Maqedoni.

Vendosja e stacionit meteorologjik do të ndihmojë projektin të ndjek kushtet e motit, që është e nevojshme për të caktuar dhe testuar teknikat e ndryshme të adaptimit ndaj kushteve klimatike në bujqësi. Me anë të bashkëpunimit me fermerët lokal në gjitha rajonet synuese të projektit, Rrjeti për Zhvillim Rural do të mundësojë zbatimin dhe përshtatjen e mëtutjeshme të këtyre teknikave edhe në shumë bashkësi tjera.



PROJEKT PËR EFIKASITET ENERGIJETIK NË KOMUNËN E VINICËS



Gjatë periudhës prej muajit maj 2012 deri në prill 2013 zgjat zbatimi i projektit “Efikasiteti energjetik në komunën e Vinicës”. Aktivitetet e projektit i zbaton Shoqata e Fermerëve Gra “Agro-Vinka” nga Vinica, në partneritet me komunën e Vinicës dhe (EPFÇF) Enti Publik Fillor Çerdhe Fëmijësh “Goce Dellçev” nga Vinica. Shuma e plotë e projektit është 49.530 \$, të cilat gjysma janë siguruar nga Programi për Grante të Vogla (PGV) i Fondit Global Ekologjik (FGE), ndërsa të tjera janë pjesëmarrje vetjake e komunës së Vinicës, EPFÇF “Goce Dellçev” Vinicë dhe Shoqata e Fermerëve Gra “AGRO-VINKA” nga Vinica.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është: zvogëlimi i ndryshimeve klimatike me anë të përdorimit të bio-

dizelit dhe zbatimi i efikasitetit energjetik, gjegjësisht rindërtim – në dy çerdhet për fëmijë “Goce Dellçev” në Vinicë me:

- Ndryshimin e dritareve dhe dyerve të jashtme nga druri me PVC profil me pesë komora,
- Intervenim në hapjen e tavanit (i paramenduar për ventilim),
- Intervenim në ndriçimin elektrik në dy objektet (ndryshim i poqëve të zakonshme me tel me poqe me fluoro-gypa dhe fluorokompakt)

Qëllimet konkrete janë: ulja e emetimit të (CO₂), zbatimi i masave dhe teknikave për efikasitet energjetik, izolim më i mirë i zërit, përdorimi i poqëve efikase energjetike, përdorimi i burimeve të ripërtërishe të energjisë – biodizel karburant

dhe mbrojtje të mjedisit jetësor.

Sipas planit të punës, prej aktiviteteve të parashikuara janë realizuar:

Një punëtori për përforcimin e kapacitetit të anëtarëve të shoqatës Agro-Vinka “**Organizimi dhe struktura e ndërmarrjeve**”

Zbatimi i 3 trajnimeve praktike (punëtori) për:

- Prezantim për përpunimin e biodizel karburantit nga vaji i përdorur për gatim
- Metoda dhe teknika për objekte efikase energjetike në Vinicë
- Prezantim për ndryshimet klimatike

Ishte zhvilluar edhe një tribunë në temën: Efikasiteti energjetik në

amvisëritë në luftën kundër ndryshimeve klimatike në Vinicë në çerdhen për fëmijë Goce Dellçev më 28.12.2012.





Rezultate parime konkrete priten të arrihen pas një viti pasi që është bërë izolim i objekteve. Si parametër më relevant krahasuese do të jenë llogaritë për energji elektrike të harxhuar, para dhe pas izolimit të objekteve dhe energjensët e harxhuar (naftë, dru, etj.). Të dhëna të hollësishme për efektet e uljes së energjisë në objektet publike, si dhe uljen e emisionit të dyoksid karbonit nga objektet publike në komunën e Vinicës do të marrim pas një viti. Të dhënat e fituara dhe efekti i projektit do të prezantohen publikisht dhe do të jetë të gatshme për gjitha palët e interesuara.

Pritet që të ketë:

1. Kursim të energjisë për 15% që pritet të arrihen me aktivitetet për efikasitet energjetik në ko-



munën e Vinicës

2. Ulje të emisionit të CO₂
3. Ulje të shpenzimeve për energji në nivelin lokal
4. Rritje të vetëdijes ekologjike si kuadër i trajnuar pas trajnimit për vullnetarë që punojnë në institucionet nga zbatimi i teknikave për efikasitet energjetik

Informata plotësuese për projektin mund të merrni nga koordinatori i projektit Olga Stojmenova në telefonin **078/390-153, 071/263-628** ose në **e-mail: agrovinka@yahoo.co.uk** ose **ostoimenova@mail.net.mk**

Më tepër informata për PGV FGE mund të gjenden në **www.gefsgpmacedonia.org.mk** dhe në **http://sgp.undp.org**



SHËNOHET DITA E NDËRKOMBËTARE TË GRUAS RURALE



eveniment në kompleksin Etno Fshat, në komunën e Staro Nagoričanë (rrethina e Kumanovës) me qëllim që bashkërisht të kontribuojmë në integrimin më të mirë të grave në jetën shoqërore dhe politike.

Ushqime të ndryshme tradicionale ishin përgatitur nga duart e shkathtë të grave të shumta nga rajone të ndryshme rurale në Maqedoni të cilat kanë marrë pjesë në evenimentin.

Me rastin e "Ditës Ndërkombëtare të Gruas Rurale" që shënohet më 15 tetor në gjithë botën, Federata e Fermerëve e Republikës së Maqedonisë – FFRM, në bashkëpunim me Rrjetin për Zhvillim Rural – RZR dhe Qendrën për Promovimin e Praktikave të Qëndrueshme Bujqësore dhe Zhvillim Rural – CeProSARD, ka organizuar një

eveniment në kompleksin Etno Fshat, në komunën e Staro Nagoričanë (rrethina e Kumanovës) me qëllim që bashkërisht të kontribuojmë në integrimin më të mirë të grave në jetën shoqërore dhe politike. Ushqime të ndryshme tradicionale ishin përgatitur nga duart e shkathtë të grave të shumta nga rajone të ndryshme rurale në Maqedoni të cilat kanë marrë pjesë në evenimentin. Dhjetë prej këtyre grave kanë marrë pjesë në garën për recetën më të mirë të përgatitur nga speci, që ishte organizuar në kuadër të evenimentit. Mesazhi i këtij viti për gjithë gratë e viseve rurale në botën ishte: "Merrni vendin e juaj në uljen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike!".





U SHËNUA DITA NDËRKOMBËTARE E PERSONAVE ME INVALIDITET, 3 DHJETORI

Shoqata e qytetarëve për persona të hendikepuar "Humanost" nga Kumanova e ka shënuar 3 dhjetorin, ditën ndërkombëtare të personave me invaliditet me një eveniment që ishte organizuar në Kumanovë, këtë të shtunë, më 1 dhjetor.

Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë ka dhënë mbështetje dhe ndihmë gjatë organizimit të eventit, dhe njëherë i ka prezantuar qëllimet dhe aktivitetet e saja para personave me invaliditet që kanë marrë pjesë në eventin. Më tepër se 20 fëmijë me pengesa në zhvillim nga organi-

zata joqeveritare "Poraka nasha" dhe "Qendra Ditore për Fëmijë me Nevoja të Posaçme" nga Kumanova, kanë bërë vepra artistike dhe stolisje nga monistra. Për gjithë ata, Rrjeti për Zhvillim Rural siguroi nga një dhuratë të vogël.

Programi ishte pasuruar me këngë popullore të interpretuar nga grupi këngëtar femëror pranë Shoqatës së Pensionerëve Invalid dhe Shoqatës Kulturore Artistike nga Kumanova. Në fund, shoqata e qytetarëve për persona të hendikepuar "Humanost" ka shpërndarë falënderime të përpunuara me dorë për gjithë bashkëpunëtorët shumëvjeçar.





FESTIVALI "CERGE BALLKANIKE"

Në periudhën prej 28-30 shtator 2012 në fshatin Shishkovcë, komuna e Qys-tendilit, Republika e Bullgarisë, u mbajt festivali "Cerge Ballkanike". Tre ditët ishin përplot me program të pasur kulturor-artistik me këngë dhe valle nga Maqedonia, Bull-garia dhe Serbia. Festivali i cergës ballkanike, folklorit dhe artizan-

eve, i bashkoi ngjyrat tradicionale të popujve ballkanikë në një cerge laramane e thurur me mendime të përbashkëta dhe interesa dhe e liruar nga barra që e bart histo-ria e Ballkanit. Rrjeti për Zhvillim rural bashkë me organizatat e saja – anëtare, morri pjesë në këtë fes-tival duke e përfaqësuar traditën dhe kulturën maqedonase.





PARLAMENTI RURAL SUEDEZ



Prej 6 deri 9 shtator, 2012 në qytetin Ronebi, në rajonin suedez Blekinge, ishte mbajtur Parlamenti Rural Suedez i 12-të me rrallë. Në evenimentin kanë mar-

rë pjesë mbi 500 pjesëmarrës nga Suedia, anëtarë të GLA-ve dhe mysafirë ndërkombëtarë – përfaqësues të më tepër se 20 shteteve nga Evropa. Në ftesë të Rrjetit për Zhvillim Rural të Suedisë, RZR i RM-së kishte përfaqësues në këtë eveniment. Ngjarjen solemnisht e hapi ministria për barazi gjinore e Suedisë z-nja Niamko Sabuni dhe nënkryetarët e rrjetit suedez për zhvillim rural „All of Sweden shall Live“ z-nja Inez Abrahamson dhe z. Kenet Nilshem.

Në këtë eveniment pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë të shkëmbejnë idetë e tyre, të japin mendime, qëndrime dhe pyetje. Ata e theksuan rëndësinë e këtij eventi për kyçjen e sektorit qytetar dhe lëvizjet për zhvillimin rural në politikat shtetërore dhe strategjive për zhvillim rural. I rëndësishëm në veçanti ishte kontributi i të rinjve si në organizimin e evenimentit, ashtu edhe në debatet për rolin e tyre në ardhmërinë e viseve rurale.





KONFERENCA KOMBËTARE ÇEKE "HAPËSIRA RURALE 2012"



Konferenca kombëtare Çeke e këtij viti ishte organizuar në periudhën prej 1-3 tetor, në qytetin e vogël Nove Hradi, që gjendet në vetëm disa kilometra nga kufiri mes Çekisë dhe Austrisë. Konferenca kombëtare "Hapësira Rurale 2012" në kohë kur një periudhë programore përfundon ndërsa tjetri është në përgatitje, në vend ku takohen dy bota tërësisht të ndryshme, në periudhë kur nuk është i qartë dallimi mes qytetit dhe pjesës rurale deri në kufirin kur bëhet vështirë të përcaktohet se çfarë është mjedis

rural. 280 përfaqësues të Grupeve Lokale Aksioni në Çeki, përfaqësues të më tepër ministrive, sektori jo-qeveritar dhe afarist në Çeki, kanë diskutuar për problemet e gjithsej 160 GLA-ve të themeluar në bazë të LEADER qasjes dhe janë munduar të gjejnë zgjidhje origjinale për vetë-qëndrueshmërinë e tyre. Në konferencën kanë marrë pjesë dy përfaqësues të Rrjetit për Zhvillim Rural të Republikës së Maqedonisë, një përfaqësues i Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi të Ujit të RM-së, përfaqësues i kompanisë



konsultente dhe këshilltari i komunës së Dellçevës. Gjatë kohës së konferencës, ata zhvilluan takim me përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë të Republikës Çeke dhe përfaqësues të disa Grupeve Lokale Aksioni nga Çekia. Në takimin ishin shkëmbyer përvojat në suaza të LEADER qasjes, zbatimin në Republikën Çeke dhe mënyra e funksionimit të GLA-ve, bashkëpunimi i tyre i ndërsjellë si dhe mundësitë për bashkëpunim ndërkombëtar.

Kjo mundësi rezultoi me një takim tjetër, këtë herë në R. e Maqedonisë, mundësi të hapura për bashkëpunim të përbashkët dhe mbështetje të ofruar nga ana e përfaqësuesve çek për zbatimin e LEADER qasjes në nivel kombëtar në Maqedoni.

